



VENDIM
Nr.67, datë 20.12.2024

**PËR MIRATIMIN E PROJEKT - BUXHETIT AFATMESËM 2025-2027 TË BASHKISË
SKRAPAR DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ.**

Këshilli i Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 20.12.2024 mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi Menaxhimit Strategjik në mbështetje, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH", neni 6,15,17,22,23,24,25,26,32, i ndryshuar me ligjin Nr.57/2016 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9936, dt.26.06.2008", ligjit Nr. 9632 datë 30.10 2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, të ligjit Nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Udhëzimit të Ministrisë Financave Nr.23, datë 30.07.2018, "Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", Udhëzimin Nr.7, datë 25.02.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.23, datë 30.07.2018 "Për Procedurat Standarde të Përgatitjes Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", Udhëzimit Plotësues të Ministrisë Financave nr.6/1, datë 28.02.2018, "Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor", Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë Nr.2, datë 28.02.2024 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", Udhëzimit Plotësues të Ministrisë Financave Nr. 8, datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027", ligjit nr. 9920, dt. 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", VKM Nr.325, Dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa Institucione të Administratës Publike", VKM Nr.326, Dt. 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike", VKM nr.422, dt.26.06.2024, VKM Nr.419, datë 26.06.2024 "Për Miratimin e Vlerave për secilin elementë përberës të pagës bruto të Punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi", VKM nr.425, datë 26.06.2024 "Për Miratimin e Strukturës dhe nivelit të pagave të Punonjësve mësimor dhe të Punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", VKM-së nr.503, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.328, datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 si më poshtë:

I- TE ARDHURAT NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE